

Z. Altin Tafilaj, ka kryer studimet në Shkollën e Lartë të Arsimit Teknologjik dhe Pedagogjik (ASPAITE) në Athinë, Greqi. Zotëron diplomë të nivelit Master Shkencor dhe Master Profesional nga ky universitet.

Karriera e tij e punës ka nisur që në Greqi në pozicione drejtuese të aktiviteteve të ndryshme private dhe trajnime në administratën publike Greke.

Në periudhën 2007-2014, ka eksperiencë në institucione publike dhe private në pozicione mbikëqyrëse dhe drejtuese në Shqipëri, si në Termocentralin e Vlorës, Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare, etj. Marrëdhëniet e punës në Kontrollin e Lartë të Shtetit i nisi në vitin 2014 dhe gjatë kësaj periudhe ka mbuluar me auditim pothuajse të gjitha fushat.

Ka marrë pjesë në shumë programe trajnimi, të mundësuar nga Institucione Ndërkombëtare Audituese të ndryshme.

Aktualisht është në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të KLSH-së.

Z. Tafilaj, ka njohuri mjaftueshëm mirë në gjuhën Greke, Angleze dhe Italiane.